



# Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XII i botimit, nr. 126, prill 2014

Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355683191817, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktor: Lazër Kodra, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

SHOQATA E VËLLAZËRISË  
KOSOVË-MALËSI E MADHE  
"MARTIN DRESHAJ"  
PEJË

me datën 25-26 Prill 2014  
në Rrafshin e Dukagjinit  
zhvillohet manifestimi

**"ZËRI I VËLLAZËRIMIT-2014"**



SHOQATA  
ATDHETARE - DUKAGJINI  
SHKODËR

## Lazër Stani: Librin e parë nuk e kam lexuar, ma lexuan

BASHKËBISEDIM ME  
SHKRIMTARIN E PUBLICISTIN  
LAZER STANI

Cili është libri më i vjetër që keni në bibliotekën tuaj? Kur e keni blerë dhe cila ishte arsyeja?


Botimet më të vjetra që gjenden në shtëpinë time janë një koleksion i «Hyllit të Dritës» botime të gjysmës së parë të shekullit të kaluar. Një enciklopedi e tërë etnokulturore, gjuhësore filozofike, historike, sociologjike, religjioz...

3

## ZEF SHYTANI - Vendosë në dorë orën e Petrit Dumes

(kujtime)

Kisha dëgjuar prej disa kohësh se ka qenë një qitës shumë i mirë nga mesi i shekullit të kaluar nga Lotajt që quhej Zef. Nuk dija më shumë për të, prandaj dhe kisha dëshirë që ta takoja e ta njohja nga afër.



5

## Një ngjarje e veçante në fshatin Toplane!

Ka qene vjeshta e vitit 1943, kur një avion luftarak vinte nga Gjako-va në drejtim të Shkodrës, por një defekt në motor, detyroi pilotin të bënte një ulje të detyrueshme duke lëshuar avionin poshtë majës së madhe "Mbi Bota" dhe piloti të hidhet me parashute e të bie në mes të fshatit, afër kishës së Toplanës.

Pjeter Gera e Mark Marashi Kapaj, të cilët në atë kohe ishin rreth moshës 8-9 vjeçare, kujtojnë sot atë zhurme të madhe, e cila tronditi të gjithë fshatin. Menjëherë fshati u alarmua dhe të gjithë fshataret, siç ishin në punët e vjeshtës u drejtuan pranë vendit ku kishte ra avioni. Fshati mësoj se, piloti kishte zbritur me parashute afër Kodër-Zarit.

5



## GËZIMI I SHKODRËS

### Bashkëbisedim me Mjeshtrin e madh të humorit shqiptar, Gëzim Kruja

Gjatë punës sime për përgatitjen e një cikli artikujsh kushtuar personaliteteve të artit dhe kulturës shkodrane kryesisht në fushën e letërsisë, skenës dhe muzikës, një vend të veçantë do të zinte edhe figura e "Mjeshtrit të Madh", shkrimtarit dhe humoristit Gëzim Kruja.

Kjo figurë e shquar e galerisë së humorit shkodran radhitet në mënyrë dinjitoze edhe me pararendësit e tij, edhe me bashkëkohësit e tij, por e gjithë gama e veprimtarisë artistike e bën atë më specifik; ai nuk është një aktor si të tjerët "klasik i skenës", por është shumë dimensional me aftësi të gjithanshme.

10

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP

Mundësoi  
Botimin:  
NDUE  
FTONI

